

LIGJ
Nr.7389, datë 8.5.1990

**PËR MIRATIMIN E DEKRETEVE TË PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË
REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 67 e 68 të Kushtetutës,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Miratohen pa ndryshime dekretet:

1. Dekretet nr.7364, datë 24.3.1990 “Për dias ndryshime në ligje e dekrete”.

2. Dekret nr.7366, datë 24.3.1990 “Për një ndryshim në dekretin nr.4650, datë 9.3.1970 “Për kufirin shtetëror të RPSSH”.

3. Dekret nr.7371, datë 24.4.1999 “Për një ndryshim në dekretin nr.4541, datë 6.9.1969 “Për prodhimin dhe tatimin e rakisë”.

II. Miratohet dekreti nr.7353, datë 13.1.1990 “Për disa ndryshime në ligjin nr.4625, datë 24.12.1969 “Për shërbimin veterinar”, me këtë ndryshim:

Neni 13/a që shtohet, të formulohet në këtë mënyrë:

“Inspektorët e shërbimit veterinar dhe organet e policisë popullore, kontrollojnë lëvizjen e kafshëve e të shpendëve brenda rrethit.

Inspektorët e shërbimit veterinar bllokojnë kafshët pa certifikata veterinare dhe i dorëzojnë në ndërmarrjet e grumbullimit të mishit, kurse shpendët pa këto certifikata theren në vend dhe i jepen pronarit për konsum”.

III. Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**
SIHAT TOZAJ

**KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**
RAMIZ ALIA